




**Raport studimor**  
**“Situata e fëmijëve jashtë kujdesit prindëror” për vitin 2012,2013 – Qarku Shkodër**



**QARKU SHKODËR**

Eksperte Rajonale  
Anilda Shestani (Gurakuqi)  
**Prill 2014**

## **LISTA E SHKURTIMEVE**

VKM	– Vendime të Këshillit të Ministrave
Observatori	– Observatori për të Drejtat e Fëmijëve
NJDF	- Njësia për të Drejtat e fëmijëve
DAR	- Drejtoria Arsimore Rajonale
DSHP	- Drejtoria e Shëndetit Publik
DP	- Drejtoria e Policisë
DRSHSSH	- Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror
UNICEF	- Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë
QZHPAK	- Qendra e Zhvillimit të personave me aftësi të kufizuara
KQ	- Këshilli i Qarkut

## I - Parathënie dhe falënderime

Observatorët për të drejtat e Fëmijëve janë tashmë prezent në cdo qark të Shqipërisë. Observatori për të Drejtat e Fëmijëve Shkodër funksionon që nga Maji i vitit 2009.

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve si një strukturë e shoqërisë civile ka forcuar tashmë aleancat në harmonizimin e bashkëpunimit duke rritur përpjekjet efektive për realizimin e të drejtave të fëmijëve. Observatorët për të Drejtat e Fëmijëve realizojnë grumbullimin periodik të treguesve statistikor nga institucionet shtetërore rajonale; (DAR, DSHP, DP etj) njësitë e qeverisjes vendore gjer në nivelin e komunave; organizatat e shoqërisë civile; komunitetet dhe vetë fëmijët në nivel rajonal dhe lokal. Mbi këta tregues realizohet analiza periodike dhe e vazhdueshme e informacionit dhe hartohen raporte vjetore lidhur me situatën e gjendjes së të drejtave të fëmijëve në fushën e së drejtës për Kujdes Shëndetësor; Mbrojtje Sociale; Edukim dhe Pjesëmarrje.

Përmes mbledhjes së informacionit mbi të drejtat e fëmijëve dhe me mbështetjen e vazhdueshme institucionale dhe bashkëpunimin e ndërsjellët të Zyrës Rajonale të Avokatit të Popullit, Observatori Shkodër ka arritur të krijojë dhe të konsolidojë tashmë mekanizmin e mbledhjes së të dhënave që lidhen me mirëqenien e fëmijëve.

Informacioni i shkëmbyer reciprokisht me institucionet rajonale apo ato të qeverisjes vendore goftë të njërive vendore si Bashki apo Komuna; gjithashtu me organizatat e qeverisjes vendore por edhe shpërndarja e raporteve përkatëse e bën Observatorin e të Drejtave të Fëmijëve “Zyrë Burimore për të Drejtat e Fëmijëve” në Qarkun Shkodër.

Një fokus të veçantë Observatori ka pasur edhe raportimin mbi të drejtat e Fëmijëve me qëllim jo vetëm paraqitjen e situatës së të drejtave të fëmijëve në Qarkun Shkodër por edhe orientimin e pushtetit vendor në promovimin e politikave favorizuese në mbrojtje të drejtave të Fëmijëve. Observatori ishte iniciator por edhe pjesë e grupit teknik për hartimin e një dokumenti shumë të rëndësishëm në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve siç është dhe Strategjia Rajonale dhe Plani i Veprimit për Fëmijët 2011-2013 të Këshillit të Qarkut Shkodër, dokument publikuar me mbështetjen financiare të Zyrës së UNICEF Shqipëri. Në të njëjtën kohë Observatori Shkodër ka ofruar të dhënat sasiore dhe cilësore që ai disponon në monitorimin e kësaj Strategjie në nivel Qarku, ekspertizë e cila u realizua nga Qendra” Fëmijët Sot” përgjatë vitit 2013.

Observatori Shkodër po bashkëpunon ngushtë me Njësinë për të Drejtat e Fëmijëve dhe Sektorin e Shërbimeve Sociale, Arsimit dhe Shëndetësisë pranë Këshillit të Qarkut Shkodër bazuar në projektin RIDE “ *Forcimi i Shërbimeve të Mirëqenies Sociale të Fëmijëve në nivel rajonal, në përgjigje të implementimit të politikës së mos përjashtimit social të fëmijëve*”. Përmes këtij projekti synohet fuqizimi i mekanizmit referues së problematikave të fëmijëve apo lidhur me zbatueshmërinë e drejtave të tyre në mënyrë fëmijët të marrin shërbime dhe të mos mbeten të përjashtuar.

Raporti Studimor “ Situata e fëmijëve jashtë kujdesit prindëror” është raporti i dytë pas atij që Observatori Shkodër hartoi në vitin 2013 konkretisht atë të “Gjendja e Fëmijëve Romë e Egjiptianë” në Qarkun Shkodër. Raporti që prezantohet është përgatitur nga Zyra e Observatorit Shkodër dhe është i bazuar në të dhënat e grumbulluara kryesisht nga fokus grupet dhe gjithashtu nga të dhëna, statistika, informacione sasiore dhe cilësore të ardhura nga institucionet rajonale të qeverisjes vendore dhe nga organizatat e shoqërisë civile.

Observatori falenderon gjithë drejtuesit e qendrave të përkujdesit social për fëmijë dhe profesionistët e tjerë në Sektorin e Shërbimeve Sociale pranë Bashkisë Shkodër, të cilët ndihmuan në ofrimin e të dhënave sasiore dhe cilësore të domosdoshme për realizimin e këtij raporti studimi. Falenderojmë znj. Rudina Kruja,( Njësia për Mbrojtjen e fëmijëve-sektori i Shërbimeve Sociale pranë bashkisë Shkodër), znj. Julia Cepi ( Drejtore pranë Qendrës së Zhvillimit); znj. Manjola Kalamishi (Drejtore pranë Shtëpisë së Fëmijës 0-3 vjeç); znj. Servete Mirashi (punonjëse sociale pranë Shtëpisë së Fëmijës 0-3 vjeç); Z. Arian Dushaj (Drejtore pranë Shtëpisë së Fëmijës Shkollor); znj. Anjeze Gjelluci (Drejtore pranë Shtëpisë së Fëmijës 3-6 vjeç); znj. Eva Luli (Shërbimi Social Shtetëror Shkodër); znj. Nineta Agovi (Punonjëse sociale pranë Shtëpisë së fëmijës 3-6 vjeç); znj. Vilma Shiroka ( Sektorin e Shërbimeve Sociale; Arsimit e Shëndetësisë në KQ Shkodër) .

Falënderojmë Z. Alfred Koçobashi, përfaqësues i Zyrës Rajonale të Avokatit të Popullit Shkodër për ndërmjetësimin dhe mbështetjen në procesin e marrjes së të dhënave statistikore lidhur me studimin.

Në përfundim të realizimit të këtij studimi, me shumë kënaqësi do dëshiroja të falënderoja në mënyrë të veçantë stafin e Observatorit Kombëtar për të Drejtat e fëmijëve (ODF), Znj. Elma Tërshana, drejtuese e ODF-së dhe stafin e Observatorëve në Shqipëri për ofrimin e gjithë mbështetjes së tyre profesionale dhe të përkushtuar, dhënë gjatë gjithë periudhës së shkrimit të këtij raport studimi.

## II – Hyrja

Qëllimi i këtij studimi është të paraqes *kornizën e situatës së fëmijëve jashtë kujdesit prindëror për vitin 2012 dhe një pjesë të vitit 2013 në qarkun e Shkodrës*, nëpërmjet analizës së të dhënave sasiore dhe cilësore që vijnë nga institucionet e përkujdesit social për fëmijët jashtë kujdesit prindëror. Gjithashtu ky studim evidenton disa nga problematikat që ndeshen gjatë zbatimit në praktikë të standardeve të shërbimeve sociale si dhe jep sugjerime për përmirësimin e mëtejshëm të standardeve për sigurimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të fëmijëve jashtë kujdesit prindëror.

Realizimi i këtij studimi *synon* që të nxjerr në pah shërbimet që përfitojnë por edhe problematikat e fëmijëve që jetojnë në institucione të përkujdesit dhe janë pa kujdes prindëror.

Objektivat e këtij studimi janë:

- Analizim i të dhënave sasiore dhe cilësore;
- Të përshkruajë në përgjithësi zbatueshmërinë e standardeve në institucionet e kujdesit social për fëmijët jashtë kujdesit prindëror;
- Të vlerësojë situatën e realizimit të të drejtave të fëmijëve që jetojnë në institucionet rezidenciale të kujdesit social;
- Të evidentojë problemet dhe bëjë rekomandime lidhur me sistemin e kujdesit social për fëmijët jashtë kujdesit prindëror.

Ky raport studimi mund t’u shërbejë Qendrave Rezidenciale për fëmijë jashtë kujdesit prindëror, Bashkive/ Komunave përkatëse ku ndodhen këto qendra rezidenciale, si dhe të gjithë komunave dhe bashkive në Qarkun Shkodër. Realizimi i këtij studimi do t’u vijë në ndihmë institucioneve të pushtetit vendor për të përmirësuar kushtet dhe standardet e jetesës së fëmijëve jashtë kujdesit prindëror. Gjithashtu, ky studim mund t’ju shërbejë dhe donatorëve të ndryshëm dhe personave të

tjerë të interesuar për të përmirësuar situatën e të drejtave të fëmijëve jashtë kujdesit prindëror , - duke synuar integrimin e plotë të fëmijëve pa kujdes prindëror në jetën sociale.

Realizimi i studimit “*Situata e fëmijëve jashtë kujdesit prindëror*”(për vitin 2012,2013) u realizua në Qarkun e Shkodrës pasi në këtë qark janë 4 institucione rezidenciale për fëmijë jashtë kujdesit prindëror, të cilët strehojnë dhe përkujdesen për fëmijë, të cilët vijnë nga e gjithë Shqipëria. Në tre Shtëpitë e fëmijëve rezidenciale të cilat ndodhen në territorin e Bashkisë Shkodër për vitin 2012 janë trajtuar 125 fëmijë të cilët kanë qënë përfitues të shërbimeve ndërsa në vitin 2013 numërohen 122 fëmijë përfitues<sup>1</sup>.

Në qarkun e Shkodrës, aktualisht nga viti 2012 e gjer tani në vitin 2014 trajtohen 29 familje kujdestare dhe shërbimi i kujdestarisë ofrohet për 25 fëmijë<sup>2</sup>.

### 1. *Metodologjia e studimit*

Metodologjia e përdorur për këtë studim është: shqyrtimi i të gjitha raporteve, dokumenteve strategjik kombëtar dhe lokale, shqyrtimi i ligjeve në fuqi, intervista me aktorë të ndryshëm kyç të institucioneve lokale, si dhe intervistimi i disa fëmijëve që janë pjesë e Institucioneve të përkujdesit.

*Shqyrtimi i legjislacionit dhe politikave aktuale:* U realizua një analizë e politikave lokale si dhe e kuadrit aktual ligjor që mbështetje të përkujdesin social në Shqipëri; u shqyrtua Kodi i familjes dhe disa ligje që lidhen me birësimin dhe arsimimin.

Strategjitë kombëtare dhe lokale, e raporte që u analizuan për qëllim të këtij studimi, kryesisht janë:

- Strategjisë kombëtare të Ministrisë së punës dhe Çështjeve Sociale për vitet 2005-2010,
- Strategjisë Sektoriale e Përfshirjes Sociale 2007-2013 dhe Planit të Veprimit të fundit 2012-2016.
- Strategjia Rajonale dhe Plani i Veprimit për Fëmijët 2011-2013, - Qarku Shkodër.
- Strategjia e Përfshirjes Sociale 2007-2013 ,Raport progresi 2008-2009 (Mars 2010) , Hartuar nga Ministria e Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe UNICEF.
- Raport i Avokatit të Popullit (viti 2012) “Për të drejtat e fëmijëve jetimë, përfshirë këtu fëmijët e sistemuar në institucionet rezidenciale të përkujdesjes shoqërore, si dhe të fëmijëve që shfrytëzohen për të punuar”.
- Te rinjtë pa kujdes prindëror (Praktika, legjislacioni dhe të drejtat), nga SOS Fshatrat e Fëmijëve.

Një seri takimesh u realizuan me përfaqësues të Institucioneve lokale si: Qendrat Rezidenciale në Shkodër, Sektori i Shërbimeve Sociale pranë bashkisë Shkodër, Sektori i Shërbimeve Sociale, Arsimi dhe shëndetësisë pranë këshillit të Qarkut etj. Gjithashtu pjesë e këtij studimi janë bërë dhe shumë informacione të mbledhura nga vetë zyra e Observatorit Shkodër.

<sup>1</sup> Informacioni është marrë nga Intervista me znj. Rudina Kruja, Sektori i Shërbimeve Sociale pranë Bashkisë Shkodër bazuar në Modularin e përfituesve të shërbimeve në Shtëpitë e fëmijëve Shkodër.

<sup>2</sup> Sipas informacionit të marrë nga specialistja e SHSR Shkodër Znj. Eva Luli (prill 2014), trajtohen 10 familje kujdestare në Bashkinë Shkodër; 1 në Komunën Postribë; 2 në Komunën Gur I Zi; 5 në Komunën Rrethina dhe 2 familje në Komunën Kastrat të Qarkut Shkodër.

U hartua dhe u shpërnda një pyetësor drejtuar drejtuesve e profesionistëve të institucioneve rezidenciale. Ky pyetësor i'u shpërnda 3 institucioneve rezidenciale dhe kishte rreth 15 pyetje të hapura. (**Aneks 2** gjeni pyetësorin e realizuar).

Realizimi i këtij studimi, pati dhe vështirësitë dhe limitizimet e tij, kryesisht të cilat janë si vijon:

- Ø Koha e shkurtër për hartimin e një raporti studimor;
- Ø Pamundësia e zhvillimit të fokus grupeve me fëmijë jashtë kujdesit prindëror, por që nuk janë pjesë e qendra rezidenciale.
- Ø Pamundësi e paraqitjes së një tabloje të plotë numerike të situatës së fëmijëve që jetojnë jashtë kujdesit prindëror dhe që rrinë me të afërmit e tyre ne nivel bashkie/komune për Qarkun Shkodër. Kjo për arsye se jo të gjithë administratorët social e disponojnë këtë informacion të detajuar në databazen e tyre.

### **Kuadri Ligjor dhe Politikat e zhvillimit:**

Shërbimet sociale për fëmijët pa kujdes prindëror janë pjesë e programit për reduktimin e varfërisë dhe programit për kujdesin social.

Legjislacioni, i cili mundëson zbatimin e programeve të sipërpërmendura është ndërtuar në përputhje me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Qeveria Shqiptare si dhe në Konventën për të Drejtat e fëmijëve.

Ndonëse në funksion të mirëqënies dhe mbrojtjes së fëmijëve ekziston një kuadër ligjor dhe institucional i mirë, ai ka ende nevojë për përmirësim në drejtim të fokusimit ndaj të rinjve pa kujdes prindëror, e veçanërisht atyre që largohen nga përkujdesi në adresim të sfidave me të cilat ata përballen në këtë fazë të jetës, gjatë moshës 14-18 vjeç dhe pas moshës 18 vjeç.

Sistemi i përkujdesit për fëmijë dhe të rinj pa kujdes prindëror bazohet në:

- Kushtetutën e Shqipërisë, v.1998
- Konventa e Kombeve të Bashkuara “Mbi të drejtat e fëmijëve”, ratifikuar v.1992.
- Karta Sociale Europiane v.1998.
- Konventa ILO nr.138.
- Konventa Hages, v.1993.
- Kodi i Familjes, Kodi i Procedures Civile, Kodi Penal.
- Ligji nr.7650 dt.17.12.1992 “Për birësimin e të miturve nga Shtetas të huaj dhe për disa ndryshime në Kodin e familjes”.
- Ligji nr.9695 dt.09.03.2007 “Për birësimin e të miturve”.
- Ligji nr.8153 dt.31.10.1996 “ Mbi statusin e Jetimit”.
- Ligji nr.9355 dt.10.03.2005 “Për Ndihmën Ekonomike dhe Shërbimet Shoqërore”.
- Ligji i organizimit dhe funksionimit të qeverisjes vendore nr.8652 dt.31.07.2000.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.307 dt. 24.05.1994 “Për shërbimet e përkujdesit shoqëror”.
- VKM nr.510 dt.24.11.1997 “Kriteret e vendosjes në institucionet rezidenciale të përkujdesit shoqëror dhe dokumentacioni i nevojshëm për pranim”.
- VKM nr.658,659 dt.17.10.2005 “Për standartet e shërbimit të përkujdesit shoqëror për fëmijët në institucionet rezidenciale”.
- Ligji mbi strehimin Social nr.9382 v.2004.

### III – Analiza e studimit

Qarku Shkodër është një nga më të rëndësishmit dhe më i madhi në Veriun e Shqipërisë. Në vitin 2012 numëron një popullsi prej 329,099 banoresh nga të cilët 85,615 janë fëmijë<sup>3</sup> të grupmoshës 0-18 vjeç. Kjo grupmoshë zë rreth 26 % të gjithë popullsisë në Qarkun Shkodër. Nën ndikimin e dukurive sociale<sup>4</sup>, të tilla si emigracioni, urbanizimi i pakontrolluar, varfëria e papunësia, dezintegrimi i familjes e divorcet, vërehet rritje e numrit dhe e shkallës së prekshmërisë sociale për kategoritë e ndryshme të fëmijëve. Konkretisht, Qarku Shkodër është me një *nivel të lartë varfërie*, krahasuar me pjesën tjetër të vendit (indeksi i varfërisë 36,7 % krahasuar me 25,4%, që është mesatarja e vendit)<sup>5</sup>.

Shndërrimet e mëdha politike, ekonomike dhe shoqërore në Shqipëri janë shoqëruar me një numër sfidash të panjohura më parë, përfshi varfërinë , papunësinë e skajshme, mungesë të shërbimeve bazë sociale, përfshirë arsimin dhe shëndetësinë si dhe valë masive emigracioni dhe migracioni. Këto dukuri kanë ndikuar në shfaqjen e kategorive të reja sociale personash të rrezikuar ose në nevojë, përfshirë këtu fëmijët jashtë kujdesit prindëror .

*Fëmijët pa kujdes prindëror* janë të gjithë ata fëmijë që nuk jetojnë me prindërit e tyre për arsye se: të dy prindërit kanë vdekur; është hequr kujdesi prindëror; janë braktisur; prindërit janë të paaftë përkohësisht ose përherë që të kujdesen për fëmijët e tyre (janë të sëmurë ose në burg); fëmijët kanë hyrë me vullnetin e tyre (përkohësisht) në strukturat e kujdesit për fëmijët; fëmijët janë vendosur në institucionet e kujdesit për fëmijët nga shërbimet sociale; fëmijët kanë ikur prej Shqipërisë të pashoqëruar nga prindërit e tyre; ose kanë qenë trafikuar.

*Fëmijë me paaftësi* (aftësi të kufizuar mendore ose fizike) janë ata fëmijë që përshfaqin vonesa të rënda në zhvillim, përfshirë vonesën mendore dhe çrregullimet psikosociale dhe fizike.

*Institucione rezidenciale të kujdesit social* janë ato struktura që ofrojnë kujdes për fëmijët pa kujdes prindëror. Në to jeta nuk zhvillohet sipas linjës së familjes, fëmijët jetojnë në grupe dhe për ta kujdeset një personel me rrogë. Këto struktura mund të jenë të ngritura mbi komunitetin, që u siguron strehë fëmijëve pa kujdes prindëror ose mund të jenë institucione rezidenciale që ofrojnë kujdes për fëmijët që vijnë prej më shumë se një bashkie ose komune

*Burimi:* Ky përkufizim është marrë nga “Vlerësim i shërbimeve të kujdesit ndaj fëmijës dhe i institucioneve për fëmijët pa kujdes prindëror”(Raport studimor i financuar nga UNICEF, Shqipëri, tetor 2005)

<sup>3</sup> Zyra e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, 2013

<sup>4</sup> Strategjia Rajonale dhe Plani i Veprimit për Fëmijë Qarku Shkodër, fq 5

<sup>5</sup> Strategjia Rajonale dhe Plani i Veprimit për Fëmijë Qarku Shkodër, fq 20

Në qarkun Shkodër në vitin 2012 numërohen rreth 223 fëmijë në qendra rezidenciale nga këto 125 fëmijë në tre Shtëpitë e Fëmijëve dhe 98 fëmijë<sup>6</sup> në Qendrën e Zhvillimit Shkodër. Aktualisht në Qarkun Shkodër nuk kemi asnjë rast familje kujdestare.

Përkujdesja nga të afërmit për fëmijët që mbesin pa prindër vazhdon të jetë një zakon dhe formë jo zyrtare, dhe kjo dhe për inertësi të rregullave e traditave të trashëguara brez pas brezi. Kjo formë përkujdesje është paksa e vështirë për t'u matur e vlerësuar, pasi ka mungesë informacioni në zyrat e bashkive dhe komunave të qarkut Shkodër<sup>7</sup>.

Sistemi i përkujdesit social për fëmijët pa kujdes prindëror paraqitet si një sistem formal dhe informal. Sistemi formal i përkujdesit është i mbështetur në një seri ligjesh, rregullash dhe institucionesh të cilat e kanë zanafillën e tyre në sistemin e vjetër ekonomiko-shoqëror, por që janë zhvilluar e përmirësuar sipas modeleve bashkëkohore<sup>8</sup>.

Sistemi formal i përkujdesit për fëmijët pa kujdes prindëror, përbëhet prej:

- a. Shërbimit të birësimit;
- b. Përkujdesit në “shtëpi familje”;
- c. Përkujdesit ndëpërmjet kujdestarisë (foster care).
- d. Përkujdesit rezidencial i tipit institucional.
- e. Përkujdesit ditor në qendra për fëmijë me probleme sociale.
- f. Shërbime ri-atdhesimi dhe ri- bashkimi me familjen, për të miturit e larguar nga Shqipëria.

Institucionet e përkujdesjes për fëmijë jashtë kujdesit prindëror sipas legjislacionit shqiptar kanë statusin e personave juridikë që zhvillojnë veprimtari jofitimprurëse nën administrimin e Shërbimit Social Shtetëror dhe Këshillit të komunës/bashkisë ku ndodhen këto institucione.

Në varësi të llojit të shërbimit social të ofruar këto institucione mund të jenë :

1. Institucione të përkujdesit rezidenciale;
2. Institucione të përkujdesit komunitare, i cili ofrohet në qendra ditore shtëpitë e individëve, apo në familjen kujdestare sipas nevojave të grupit.

Institucionet e përkujdesjes sipas mënyrës së financimit mund të jenë:

1. Institucione publike rezidenciale të përkujdesjes;
2. Institucione private rezidenciale të përkujdesjes.

Në qarkun Shkodër përgjatë vitit 2012 e 2013 kanë funksionuar katër institucione që trajtojnë fëmijë jashtë kujdesit prindëror, të cilat janë :

1. **Shtëpia e Fëmijës 0-3 vjeç, Qendër Komunitare Ditore për fëmijë 0-6 vjeç, Shkodër.**
2. **Shtëpia e Fëmijës 3-6 vjeç Shkodër.**
3. **Shtëpia e Fëmijës 6-14 vjeç Shkodër.**

<sup>6</sup> Duhet theksuar se pavarësisht se përfitues të Qendrës së Zhvillimit janë edhe persona në moshë më të madhe se 18 vjeç me legjislacionin shqiptar ato konsiderohen dhe duhet të trajtohen për shkak të aftësisë së kufizuar si grupmosha 0-18 vjeç.

<sup>7</sup> Nga biseda e zhvilluar me Znj. Vilma Shiroka (Sektori i shërbimeve Sociale, Arsimit dhe Shëndetësisë pranë KQ Shkodër)

<sup>8</sup> Të rinjtë pa kujdes prindëror, SOS Fshatrat e fëmijëve, 2009.



#### 4. Qendra e Zhvillimit të PAK Shkodër.

Në këto institucione trajtohen fëmijë jetim biologjik, fëmijë jetim social dhe fëmijë me aftësi të kufizuar. Fëmijët që mund të përfitojnë shërbime sociale në sistemin aktual kategorizohen si më poshtë:

- “*Jetimë biologjikë* – fëmijë prindët e të cilëve nuk jetojnë e të cilët nuk kanë të afërm të tjerë që të kujdesen për ta”;
- “*Jetimë socialë* – fëmijë të lindur jashtë martese, të cilët në rrethana të caktuara, nuk mund të rriten prej nënave të tyre; fëmijë të braktisur – kur një prind refuzon kujdesin për fëmijën e tij, duke ndërprerë kështu marrëdhëniet prind-fëmijë në një mënyrë të pakthyeshme e të vetëdijshme (fëmijët braktisen në maternitetet prej familjesh në krizë morale ekonomike e shëndetësore ose prej prindësh që ikin për në vende të tjera); fëmijë që mbeten përkohësisht pa prindër (prindët e tyre janë në spital, burg ose të sëmurë rëndë); fëmijë prej familjesh pa asnjë të ardhur, ose me të ardhura të pamjaftueshme; fëmijë prej familjesh në krizë si dhe fëmijë prindët e të cilëve kanë emigruar ose dëshirojnë të emigrojnë.

Numri i fëmijëve në total në tre shtëpitë e fëmijës për vitin 2012 është 125 fëmijë nga të cilët: 89 fëmijë trajtohen me shërbim rezidencial dhe 36 fëmijë me shërbim ditor. Gjithashtu sipas grupmoshave përfitues të shërbimeve janë 83 fëmijë të moshës 0-6 vjeç; 42 fëmijë të moshës 6-15 vjeç; për grupmoshën 15-18 vjeç nuk ka informacion ndërsa 96 fëmijë janë me interesim të familjes dhe vetëm 8 fëmijë pa familje. Nga statistikat e marra rezultojnë 42 fëmijë që trajtohen në këto institucione dhe që frekuentojnë arsimin apo sistemin edukativ.

**Tabela 1:** Numri i fëmijëve në qendra rezidenciale për vitin 2012 e vitin 2013 në Qarkun Shkodër.

**Burimi:** Sektori i Shërbimeve Sociale, Bashkia Shkoder, Janar 2014.

Grupmosha	Viti 2012 3 shtëpitë e fëmijeve	Viti 2013 3 shtëpitë e fëmijeve
0-6 vjeç	83	81
6-15 vjeç	42	41
15-18 vjeç	Nuk ka informacion	Nuk ka informacion
Me interesim të familjes	96	36
Pa interesim të familjes	8	6
Që frekuentojnë shkollën	42	41
Që marrin shërbim rezidencial.	89	101
Që marrin shërbim ditor.	36	21
Total përfitues	125	122

Shërbimet<sup>9</sup> që ofrohen në Shtëpitë e fëmijëve janë:

- Trajtim psiko-social;
- Integrim në jetën sociale;
- Shërbim mjekësor;

<sup>9</sup> Guida e shërbimeve sociale, Shkodër, botimi 2.

- Kthim në familjen biologjike;
- Mirërritje dhe kujdes shëndetësor;
- Këshillim për nënat;
- Birësim i fëmijëve;
- Aktivitete të ndryshme edukuese dhe argëtuese;
- Kampe verore.

Për fëmijët me aftësi të kufizuar, qëndrimi në përkujdes është më i gjatë dhe dalja nga përkujdesi shoqërohet ose me bashkim të familjes ose sistemin e tyre përfundimtar në qendra për të rritur me aftësi të kufizuar, ku aplikohet gjysmë pavarësia. Qendrat e Zhvillimit mund të kenë status rezidencial dhe ditor. Fëmija mund të vendoset në këto qendra deri në moshën 18 vjeç.

Shërbimet që ofrohen në Qendrat e Zhvillimit<sup>10</sup> janë:

- Shërbim psiko-social;
- Pedagogji
- Logopedi
- Fizioterapi
- Ergoterapi
- Terapi okupacionale
- Trajtim mjekësor
- Bashkëpunim prind-institucion
- Aktivitete argëtuese.


Nga të dhënat e marra lidhur me Qendrën e Zhvillimit Shkodër, rezulton se në vitin 2012 është ofruar shërbim për 98 fëmijë<sup>11</sup> me aftësi të kufizuar. Në fakt duhet theksuar se përfitues janë persona më të mëdhenj se moshë 18 vjeç kjo pasi sipas legjislacionit shqiptar përfituesit në këto qendra trajtohen si individë/fëmijë të grupmoshës 0-18 vjeç.

Përgjatë vitit 2012, 46 persona morën shërbim rezidencial dhe 52 morën shërbim ditor.

Edhe përgjatë vitit 2013 kanë marrë shërbim rezidencial 46 persona nga të cilët vetëm 2 janë të grupmoshës 0-18 vjeç<sup>12</sup>, kurse 44 nga to janë mbi moshën 25 vjeç. Ndërsa shërbim ditor kanë marrë 52 fëmijë nga të cilët 33 marrin shërbim të plotë ditor e pjesa tjetër terapi 1-2 orë.

Grafiku i mëposhtëm tregon se në vitin 2012 Qendra e Zhvillimit Shkodër trajtoi me shërbime 98 përfitues nga të cilët 55 kishin Aftësi të kufizuar mendore dhe 43 Aftësi të kufizuar fizike.

*“G, aktualisht 24 vjec është përfitues i shërbimeve rezidenciale të Qendrës së Zhvillimit Shkodër. Ai duke qënë pjesë dhe përfitues i terapisë së muzikës me kalimin e kohës i është zgjuar talenti për muzikën. Tani ai është pjesëmarrës në shumë aktivitete të ndryshme duke luajtur në organo”.*



<sup>10</sup> Guida e shërbimeve sociale, Shkodër, botimi 2

<sup>11</sup> Sektori i Shërbimeve Sociale, Bashkia Shkodër.

<sup>12</sup> Nga intervista me drejtoreshen e Qendres se Zhvillimit Shkoder, znj. Julia Cepi, interviste e zhvilluar me dt. 31.01.2014 këto dy fëmijë i përkasin grupmoshës 11-13 vjeç.

Nga diskutimet e realizuara dhe me intervistat e realizuara në kuadër të këtij studimi, disa nga shkaqet kryesore mbi ekzistencën fëmijëve jashtë kujdesit prindëror janë:

1. Problemet sociale dhe ekonomike të familjes;
2. Divorcet e prindërve dhe mospranimi i fëmijës nga asnjë prej prindërve ose pamundësia e mbajtjes së fëmijëve nga njëri prind;
3. Vdekja e prindërve ose e njërit nga prindërit dhe pamundësia financiare e mbajtjes së fëmijëve nga prindi tjetër;
4. Papunësia dhe vështirësitë tepër të mëdha ekonomike të prindërve për t'u kujdesur për fëmijët;
5. Papërgjegjshmëria e prindërve për t'u kujdesur për fëmijën e tyre;
6. Mungesa e strehimit;
7. Dhuna në familje;
8. Numri i madh i fëmijëve në familje;
9. Paaftësia fizike apo mendore (aftësia e kufizuar) që mund të ketë fëmija;
10. Shtatzënitë e hershme të vajzave të cilat nuk mund t'i mbulojnë shpenzimet e rritjes së fëmijës apo për arsye të mentalitetit detyrohen t'i braktisin.

Si të gjithë fëmijët edhe këta fëmijë kanë të drejta, disa prej të cilave janë :

- Fëmijët mund të vendosen në këto institucione vetëm nëse kjo zgjedhje përkon me plotësimin e të drejtave dhe nevojave të tyre,
- Këtyre fëmijëve, edhe pse janë larguar nga prindërit e tyre, duhet t'u sigurohen kontakte të rregullta me familjet e tyre.
- Fëmijët jashtë kujdesit prindëror, të cilët janë motra dhe vëllezër, kanë të drejtë të qëndrojnë bashkë në të njëjtin institucion dhe nëse nuk është e mundur të sigurohen kontaktet e rregullta midis tyre.
- Të drejtën për t'u respektuar dinjiteti i tyre.
- Të drejtën për respektim të përkatësisë etnike, kulturore, fetare dhe gjuhësore.
- Të drejtën për respektim të jetës private, dhe intimitetit të tyre gjatë jetesës në institucion.
- Të drejtën për një përkujdesje shëndetësore cilësore.
- Të drejtën për mundësi të barabarta arsimit, përkujdesje shëndetësore, kualifikimi profesional etj gjatë jetesës së tyre kolektive.
- Të drejtën për të pasur qasje në të gjitha llojet e shkollimit, trajnimit apo kualifikimit profesional.
- Të drejtën e pjesëmarrjes në vendimmarrjet lidhur me kushtet e jetesës së tij në institucion.
- Të drejtën për t'u informuar lidhur me të drejtat që ai ka dhe rregullat në institucionet e përkujdesjes.
- Të drejtën për t'u përgatitur për jetesën e pavarur apo kalimin në një formë tjetër përkujdesjeje.
- Të drejtën për t'u ankuar tek një organ i pavarur dhe i përcaktuar për të siguruar respektimin e të drejtave të tij themelore.

Fëmijët e ndodhur në institucione rezidenciale duhet të gëzojnë të gjitha të drejtat si çdo fëmijë tjetër që jeton në familje biologjike, por fatkeqësisht këto të drejta nuk zbatohen njëjloj në një pjesë të madhe rastesh. Si rezultat i disa studimeve në këtë drejtim, fëmijët në këto institucione

rrezikohen të abuzohet emocionalisht, shfrytëzohen e keqtrajtohen . Por dhe nga vëzhgimet dhe opinionet e mbledhura nga fokus grupet e organizuara (për qëllim të këtij studimi), u përmend që ka shkelje të të drejtave të këtij grupi fëmijësh, të cilat mund të vinë nga një sërë faktorësh që janë:

- Largimi nga përkujdesja në moshë të hershme (14-vjeç) dhe mungesa totale e shërbimeve mbështetëse për këta fëmijë.
- Mungesa e shërbimeve sociale në shtrirje gjeografike më të gjerë (që të mundësoj akomodimin e fëmijëve në qendra sa më pranë familjes së tij/ saj);
- Mungesa e shërbimeve sociale të ngritura mbi bazë komuniteti, qendra ditore.
- Model të papërshtatshëm përkujdesi për arsye se u duhet të lëvizin në disa qendra gjatë rritjes së tyre duke u shkëputur kështu nga të afërmit apo motra vëllezër që mund të kenë në qendër.
- Për arsye se stigmatizohen nga shoqëria. Ky është një nga grupet që stigmatizohet që në moshë të vogël dhe derisa ata rriten, pothuajse përgjatë gjithë jetës.
- Mungesë e mbështetjes nga aktorët lokal;
- Mungesave e kushteve në qendra rezidenciale.

Në Qarkun Shkodër operojnë tashmë prej vitesh organizata të shoqërisë civile të cilat ofrojnë ekspertizë dhe profesionalizëm në trajtimin e fëmijëve jashtë kujdesit prindëror siç mund të përmendim: Madonnina dell Grappa, Projekti Shpresa, Papa Giovanni 23 etj.

Maddonina dell Grappa ka ngritur dhe po financon shërbimin për fëmijë dhe persona me aftësi të kufizuar. Në Qendrën e saj “Ravasko” e cila është e profilizuar në trajtimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar në vitin 2013 morën shërbime psiko sociale e edukative 11 fëmijë (vajza) të grumoshës 6-15 vjeç.

Ndërsa në një Qendër tjetër të Madonnina dell Grappa trajtohen 17 klientë të grupmoshës mbi 16 vjeç me shërbim rezidencial; nga këto 12 pa interesimin e familjes dhe 5 me interesim të familjes.

(nga intervista me znj.Rudina Kruja- Sektori i Shërbimeve Sociale, Bashkia Shkodër).

Pranimi dhe vendosja e fëmijëve në institucionet e përkujdes-it kryhet sipas kritereve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.<sup>13</sup>

Në rastet e fëmijëve në rrezik të lartë, fëmijë që gjenden në rrugë apo kanë humbur prindërit në ndonjë tragjedi duhet të akomodohen menjëherë në këto qendra rezidenciale dhe pastaj behet dokumentacioni përkatës. Në raste të tjera duhet të plotësohet dokumentacioni i nevojshëm pastaj të behet transferimi i fëmijës.

<sup>13</sup> Sipas Ligjit Nr. 8153, datë 31.10.1996 dhe VKM Nr. 209, datë 12.04.2006 “Për përcaktimin e kritereve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin në institucionet rezidenciale, publike dhe private të përkujdesit shoqëror”.

**Tabela 3:** Hyrje të reja të fëmijëve në qendra gjatë vitit 2012 e 2013**Burimi:** Institucionet rezidenciale në Qarkun Shkodër (Janar 2014)

	Numri i fëmijëve të hyrë për 2012	Numri i fëmijëve të hyrë për 2013
Shtëpia e fëmijës 0-3 vjeç	13 fëmijë ( 6 në shërbimin rezidencial dhe 9 në Shërbimin ditor)	11 fëmijë (4 në shërbimin rezidencial dhe 8 në Shërbimin Ditor)
QZHPAK	-	8 në shërbim ditor
Shtëpia e fëmijës 3-6 vjeç	-	Nuk ka
Shtëpia e fëmijës Shkollor	7 Fëmijë	13 fëmijë

Në të gjitha institucionet e përkujdesit, ka dosje për çdo fëmijë me vlerësimin e nevojës përkatëse, planin e përkujdesjes si dhe me dokumentacionin përkatës sipas Ligjeve në fuqi<sup>14</sup>.

*Fëmijët e braktisur social* në këto institucione përbëjnë më së shumti fëmijët që ndodhen në qendrat rezidenciale. Kjo tregon që një përqindje e madhe e familjeve nuk mund t'i mbajnë dot fëmijët e tyre për arsye ekonomike apo të ndonjë paaftësie fizike apo mendore që mund të ketë ose njëri nga prindërit ose vetë fëmija.

Një moment tjetër me rëndësi është dhe përgatitja e fëmijëve për largimin nga qendra . Për çdo fëmijë që do të largohet nga qendra për të shkuar te familja birësuese apo te familja biologjike përgatitet plani individual i largimit nga qendra. Ri-integrimi i fëmijës në familjen biologjike, familjen birësuese apo jeta e pavarur varet shumë nga përgatitja paraprake e fëmijës në këtë periudhë. Kjo është një procedurë shumë e rëndësishme ku punonjësit e qendrave japin kontributin e tyre në maksimum që ky fëmijë të ndihet sa më mirë në momentin e largimit.

Fëmija largohet nga institucioni kur ai kthehet në familjen biologjike , birësohet apo kur mbush moshën 14-18 vjeç.

**Tabela 4:** Largimet nga institucionet për vitin 2013 për Institucionet e Përkujdesit, Qarku Shkodër**Burimi:** Institucionet rezidenciale në Qarkun Shkodër (Janar, Shkurt 2014)

	Numri i fëmijëve të larguar
Shtëpia e fëmijës 0-3 vjeç	16
Shtëpia e fëmijës 3-6 vjeç	13
Shtëpia e fëmijës Shkollor	12
Qendra e Zhvillimit PAK	9

Arsyet e largimit të një pjese të fëmijëve nga shtëpia e fëmijës 0-3 vjeç Shkodër, gjatë vitit 2013, janë :

- 2 fëmijë u birësuan (jashtë shteti);
- 1 fëmijë u transferua në Shtëpinë e Fëmijës Shkollor;

<sup>14</sup> Ligji Nr. 8153, datë 31.10.1996; VKM Nr. 209, datë 12.04.2006 "Për përcaktimin e kritereve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin në institucionet rezidenciale, publike dhe private të përkujdesjes shoqërore".

- 2 fëmijë u kthyen në familjen e tyre biologjike.
- 11 fëmijë u larguan në klasë të parë.

Arsyet e largimit të fëmijëve përgjatë vitin 2013 nga shtëpia e fëmijës 3-6 vjeç janë:

- 5 fëmijë u rikthyen në familjen biologjike;
- 8 fëmijë për shkak të moshës u transferuan në shtëpinë e fëmijës 6-15 vjeç.

Ndërsa nga 12 largime të fëmijëve në Shtëpinë e Fëmijës Shkollor, 9 prej tyre u rikthyen në familjen biologjike.

Arsyet e largimit të fëmijëve përgjatë vitin 2013 nga Qendra e Zhvillimit janë:

- 9 persona PAK për shkak të plotësimit të moshës.

Ajo që është problematike dhe sjell ndikimet e saj dhe në të ardhmen është çfarë ndodh me këta fëmijë pas mbushjes së moshës 14 vjeç?

- Në momentin kur mbushin moshën 14 vjeç këta fëmijë akomodohen pranë konvikteve të shkollave të mesme. Në përgjithësi konviktet në Shqipëri nuk kanë një infrastrukturë të mirë. Këta fëmijë kanë mungesa të shumta financiare, përkrahje institucionale por dhe stigmatizohen nga komuniteti përreth.

Pasi mbushin moshën 18 vjeç këta jetim janë të pavarur POR të pa përgatitur për jetën. Atyre nuk u sigurohet *strehim dhe punë*; megjithëse në ligjin Nr. 8153, datë 31.20.1996 “Për Statusin e Jetimit” në 22 nenet e tij, përcaktohen qartë se cilat janë përparësitë e fëmijëve jetim, por ato nuk gjejnë zbatim.

Trajtimi me *ndihmë ekonomike*, në rast papunësie, për kategorinë e jetimëve mbi moshën 18 vjeç, ku ato përfshihen në skemën e përfitimit të ndihmës ekonomike, - mendoj se nuk është e përshtatshme me plotësimin e plotë të nevojave të tyre materiale. Ata janë të pa strehë dhe me një nivel të ulët arsimor. Këto faktorë bëjnë që ky grup të bëhet një grup vulnerabel dhe më i prekur nga problemet sociale si varfëria, shëndet të dobët, në jo më pak raste bëhen pre e trafikimeve apo abuzimeve si dhe pre e përdorimit të substancave të ndaluara.

Nga intervistat që u zhvilluan me drejtues, punonjës por dhe nga vëzhgimet tona në institucionet rezidenciale kemi vënë re që kushtet e këtyre qendrave janë *disi të mira*. Për t’u adresuar për përmirësim janë kushtet e infrastrukturës së Qendrës së Zhvillimit Shkodër (si në aspektin e dusheve, tualeteve, mensës e cila është shumë e amortizuar) për të ofruar mundësinë e trajtimit me standarte të shërbimeve që marrin klientët në këtë qendër.

## **E drejta e kujdesit shëndetësor**

Në të gjitha qendrat ka një plan individual për çdo fëmijë për kujdesin shëndetësor që nga lindja, ecuritë e sëmundjeve dhe alergjive të ndryshme. Fëmijët e marrin shërbimin shëndetësorë pranë ambulancave të lagjeve apo qendrave shëndetësore në të cilat ndodhen por dhe në raste emergjente në spitalin pediatrik apo në laboratorët jo publik.

Fëmijët e qendrave rezidenciale kryejnë rregullisht vizitat mjekësore pranë qendrave shëndetësore si dhe vaksinimin e rregullt sipas grupmoshave. Aktualisht gjatë intervistimeve në terren në

Shtëpinë e fëmijës 3-6 vjeç mjekes së qendrës i kish mbaruar kontrata ndërsa shërbimet shëndetësore kryheshin nga qendrat shëndetësore apo spitali.

### **E drejta për t'u ushqyer**

Këta fëmijë në momentin që bëhen pjesë e qendrave rezidenciale gëzojnë të drejtën e ushqimit sipas nevojave të tyre dietike dhe shëndetësore. Nga të gjitha intervistat në qendrat rezidenciale, jemi informuar se vaktet e fëmijëve janë të pasura me ushqime organike dhe dietë të pasur, dhe se në varësi të nevojave të tyre dietike ofrohen suplementa shoqëruar për çdo fëmijë. Në secilën qendër rezidenciale, ushqimi përgatitet në kuzhinat përkatëse në kushte të përshtatshme higjieno-sanitare dhe shërbehet në dhomën e caktuar si mensë për këta fëmijë. Menuja ditore përcaktohet në bazë të kuotave ushqimore për këta fëmijë sipas vendimit 114 dt 31.01.2007 në të cilën përcaktohet se kuota ditore për ushqim për fëmijë është *330 lekë*. Por problemet janë prezente në raste kur nuk mbulohen dot kërkesat ushqimore të fëmijëve për shkak të pamjaftueshmërisë së fondeve.

### **E drejta për arsim**

Të gjitha institucionet rezidenciale duhet të respektojnë të drejtat e fëmijëve për arsim.

Në shtëpinë e fëmijës 3-6 vjeç, përgjatë vitit 2012, *6 fëmijë* janë të përfshirë në sistemin edukativ në shkollën publike “Mati Logoreci” dhe 1 në shkollën Speciale “3 Dhjetori”. Ndërsa fëmijët e tjerë rezidencial e marrin shërbimin e kopshtit brenda institucionit. Është punuar edhe në drejtim të përfshirjes së këtyre fëmijëve në kopshte publike por ka qenë e pamundur për shkak se fëmijët nuk ambjentoheshin<sup>15</sup>. Përparimi në mësimet e këtyre fëmijëve ka qenë shumë i mirë dhe gjithashtu edhe mbështetja e stafit pedagogjik të shkollës.

2 nga fëmijët e qendrës së zhvillimit frekuentojnë shkollën publike “Pashko Vasa” në Shkodër. Rezulton një mbështetje nga stafi pedagogjik dhe një mbarëvajtje e mirë e procesit edukativ të këtyre fëmijëve. Shoqërimi i këtyre fëmijëve bëhet nga punonjësja sociale e qendrës.

Në shtëpinë e fëmijës 0-3 vjeç dhe Qendrën komunitare Ditore 0-6 vjeç shërbimi edukativ ofrohet brenda institucionit me edukatore të profilizuara dhe të diplomuara.

Përgjatë vitit 2012 dhe 2013 numërohen 42 fëmijë të Shtëpisë së Fëmijës Shkollor, të cilët frekuentojnë shkollat publike 9 vjeçare: “Salo Halili”; “Xheladin Fishta”; shkollën Speciale “3 Dhjetori” dhe gjithashtu 1 fëmijë ka frekuentuar kopshtin.

Në secilën nga institucionet ka dhoma studimi ose klasa edukative ku këta fëmijë mund të bëjnë detyrat apo dhe të mësojnë me ndihmën e edukatoreve. Koha e lirë nga këta fëmijë organizohet nëpërmjet lojërave psiko sociale, lojëra didaktike argëtuese si dhe ekskursionet, lexime, diskutime mbi çështje problematike për ta por dhe duke bërë punime në mini atelietë që kanë këto qendra.

Në momentin kur këta fëmijë mbarojnë arsimin e detyruar 9-vjeçar transferohen në konvikte të shkollave të mesme ku aty zhvillojnë dhe arsimin e mesëm.

### **E drejta për pjesëmarrje**

Fëmijët marrin pjesë në hartimin e planeve të tyre individuale brenda institucionit. Nga intervistat e zhvilluara rezulton se për çdo fëmijë të vendosur në institucione ka dosje personale dhe një Plan Individual. Aspekti për të shprehur mendimin rreth këtij plani shpeshherë lidhet me moshën e

---

<sup>15</sup> Nga intervista me punonjësja sociale të kësaj shtëpie fëmijë, znj. Nineta Agovi, Shkurt 2014.

fëmijës apo me aftësinë e tij për të kuptuar. Por një plan i tillë individual konsultohet më prindër të fëmijëve apo kujdestarë të tyre. Por pjesëmarrja e fëmijëve nuk është shumë aktive dhe gjithashtu e kufizuar me atë çfarë ofron realiteti.

Mendimi i fëmijëve merret parasysh në lidhje me çështje personale si psh veshja etj.

Ndërsa lidhur me aktivitetet argëtuese, raportohet se zhvillohen brenda ambjenteve duke respektuar mendimet e fëmijëve por edhe jashtë. Këto të fundit konsiderohen shumë të rëndësishme për të nxitur gjithëpërfshirjen dhe për t'i dhënë fëmijëve aftësinë për t'u përshtatur me ambiente të tjera përveç qendrës ku ato janë akomoduar. Shkak për mungesën e aktiviteteve jashtë ambjenteve të qendrës bëhen edhe mungesa e fondeve.

#### **IV - Prezantimi i gjetjeve kryesore dhe Rekomandime**

Më poshtë janë të paraqitura disa rekomandime që kanë dalë gjatë hartimit të këtij raporti:

- Ø Ka mungesa të programeve të tipit qendër ditore në institucionet rezidenciale. Në shtëpinë e fëmijës 3-6 vjeç nuk funksionon më që prej dy vitesh qendra ditore për shkak të mungesës së personelit (mungesa e fondeve). Rekomandohet ngritja e shërbimeve të kujdesit social ditor, shtëpi familje, qendra multidisiplinare etj.
- Ø Në nivel Qarku Shkodër nuk ka një Qendër të përkohshme pritjeje për rastet emergjente të fëmijëve. Ngritja dhe funksionimi i saj do mundësonte trajtimin e shpejtë të fëmijëve edhe pa kujdes prindëror.
- Ø Ngritja e shërbimeve mbështetëse për fëmijët 15-18 vjeç që lëjnë përkujdesin. Sigurimi i strehimit për këtë kategori. Rritja e kohës së qëndrimit në përkujdes dëri në përfundim të sistemit edukativ. Monitorimi i këtij procesi.
- Ø Ekziston nevoja për trajtimin e çështjeve juridike të problemeve që shoqërojnë fëmijët jashtë kujdesit prindëror dhe në institucionet e tilla mungon figura e juristit apo këshilluesit ligjor.
- Ø Krijimi i kushteve infrastrukturore më të përshtatshme për Qendrën e Zhvillimit Shkodër. Ky aspekt adresohet në përmirësim të kushteve në ambientet e tualeteve, dusheve, mensës etj.
- Ø Numri i PAK në një moshë madhore vështirëson akomodimin e tyre në Qendrën e Zhvillimit. Pra marrin trajtim klientë në një moshë të madhe.
- Ø Për arsye të buxheteve që janë gjithmonë jo të mjaftueshme për të mbuluar të gjitha shpenzimet e qendrave rezidenciale, ka gjithmonë nevoja të pa plotësuara dhe të drejta të shkelura.
- Ø Trajtimi apo përfshirja me shërbime duhet të ofrohet edhe për fëmijë të zonave rurale. Për shkak të buxhetit të pamjaftueshëm për të mbuluar koston e transportit, 6 fëmijë të zonave rurale nuk mundën të marrin shërbime nga Qendra e Zhvillimit Shkodër.
- Ø Pjesë e rëndësishme është dhe trajtimi i stafit, ka nevoja të vazhdueshme që të rritet kualifikimi i punonjësve.
- Ø Rritja e numrit të stafit (me punonjës social; mjekë) dhe kualifikim i vazhdueshëm mbi standardet e shërbimeve shoqërore.
- Ø Sistem statistikash lidhur me fëmijët jashtë kujdesit prindëror në komuna për të bërë të mundur identifikimin dhe ofrimin e shërbimeve ndaj kësaj kategorie.



## **BIBLIOGRAFI**

Strategjia Sektoriale e Përfshirjes Sociale 2007-2013 dhe Planit të Veprimit të fundit 2012-2016.

Strategjia Rajonale dhe Plani i Veprimit për Fëmijët 2011-2013, - Qarku Shkodër.

Strategjia e Përfshirjes Sociale 2007-2013 ,Raport progresi 2008-2009 (Mars 2010) , Hartuar nga Ministria e Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe UNICEF.

Raport i Avokatit të Popullit (viti 2012) “Për të drejtat e fëmijëve jetimë, përfshirë këtu fëmijët e sistemuar në institucionet rezidenciale të përkujdesjes shoqërore, si dhe të fëmijëve që shfrytëzohen për të punuar”.

Faqe interneti : <http://www.komitetibiresimeve.com.al>

Raport studimor “Vlerësim i shërbimeve të kujdesit ndaj fëmijës dhe I institucioneve për fëmijët pa kujdes prindëror” (financuar nga UNICEF, Shqipëri); Tetor 2005;

“Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijëve nën kujdestarinë e institucioneve të përkujdesjes sociale”, Ilda Melo 2011;

Qendra Kombëtare Shqiptare për Studimet Sociale & Fshati i Fëmijëve SOS “Analiza e situatës së të Drejtave të Fëmijëve”; Mirela Muca, Vilma Kolpeja, Almandina Guma, Mars 2009.

**ANEKS 1: Pyetësi drejtuar punonjësve të institucioneve rezidenciale në Qarkun Shkodër, Janar, Shkurt 2014**

1. Cilat janë arsyet e braktisjes, lënies së fëmijëve jashtë kujdesit prindëror?  
Cilat janë ato probleme sociale që çojnë drejt braktisjes/daljes se fëmijëve jashtë kujdesit prindëror?
2. Sa i lehtë është pranimi në institucione te përkujdesjes?
3. Cilat janë problemet që u sjell qëndrimi në qendra rezidenciale fëmijëve? Çfarë u siguron qendra fëmijëve?
4. Cilat janë problemet sociale që u sjell qëndrimi në institucione rezidenciale këtyre fëmijëve?
5. Cilat janë kushtet e qendrës tuaj rezidenciale,problematikat e kësaj qendre ?
6. Cilat janë alternativat më të mira se qendra rezidenciale?
7. Çfarë mund të bëjnë aktorët lokal për këta fëmijë ?
8. Çfarë mund të bëhet më shumë në lidhje me përfshirjen sociale për këta fëmijë?

**ANEKS 2: Pyetësi i përdorur gjatë takimeve me drejtues /punonjës në Institucionet e përkujdesjes, Shkodër (Janar, Shkurt 2014).**

**Pyetje që përmblihen ne pyetësin qe do të zhvillohet me drejtuesit e institucioneve rezidenciale :**

**(këto pyetje janë hartuar duke u bazuar në Standardet e shërbimeve të përkujdesit Shoqëror për fëmijë në institucione rezidenciale)**

Emri i institucionit :

Drejtuesi:

Vendndodhja:

Datë:

Nr kontakti :

**1. Çfarë lloj institucioni është ?**

.....

**2. Sa është numri i fëmijëve që trajtohen në këtë institucion për vitin 2011 :**

<b>Sipas grupmoshës</b>	<b>Rezidencial</b>	<b>Ditor</b>
0-3 vjeç		
3-6 vjeç		
6-14 vjeç		
Mbi 14 vjeç		
<b>Sipas gjinisë</b>		
Meshkuj		
Femra		
Rom/ Egjiptian		
<b>Sipas Statusit:</b>		
I Braktisur		

Jetim Etj (specifiko)		
<b>Sipas Kohëzgjatjes në institucion :</b> -më pak se 1 vit -1-2 vjet -më shumë se 10 vjet		
<b>Sipas Vendlindjes</b>		

3. A ka dosje për secilin fëmijë me vlerësimin e nevojës përkatëse, planin e përkujdesjes, dosje personale me dokumentet përkatëse sipas ligjit?
4. Sa është numri i fëmijëve të larguar nga këto qendra rezidenciale për vitin 2012 dhe 2013?  
Sipas : - Grupmoshës dhe Arsyës së largimit
5. A interesohen prindërit e fëmijëve shpesh pranë institucionit tuaj ? A janë prindërit e fëmijëve të interesuar dhe bashkëpunues në zhvillimin e tyre intelektual? Cilat janë politikat që ndjek institucioni juaj për afrimin e fëmijëve me prindërit e tyre ?
6. A mbështeten e përgatiten këta fëmijë për t'u larguar nga qendra? A bëhet monitorimi i vazhdueshmëm pasi fëmija largohet nga përkujdesi?
7. A marrin fëmijët ushqime e lëngje sipas nevojave të tyre dietike e te moshës? A është ky ushqim i shëndetshëm e higjienik? Stafit dhe fëmijët a i hanë vaktet se bashku ?
8. A përfshihen fëmijët në marrjen e vendimeve për veshjen , prerjen e flokëve ?
9. A këshillohen fëmijët në lidhje me përdorimin e tualetit, higjienën e tyre personale, si të përdorin produktet kozmetike etj...?
10. A ka një plan individual për secilin fëmijë për kujdesin shëndetësor që nga lindja, ecurinë e sëmundjeve , alergjitë etj? A kanë akses te shërbimet e specializuara për AK ? A bëhen vizita mjekësore periodike për këta fëmijë ? Ku vizitohen këta fëmijë ? A ka shërbim mjekësor të vendosur në këtë qendër? Cilat janë problematikat shëndetësore të cilat prekin më shumë Fëmijët ? Vaksinohen rregullisht Fëmijët ?
11. A nxitet edukimi të fëmijët? A ka mjedis studimi, biblioteke ? A kanë këta fëmijë materialet e nevojshme shkollore? Sa nga këta fëmijë frekuentojnë shkollën ? Në cilën shkollë shkojnë ? Si janë rezultatet në mësimet të këtyre nxënësve ? A pranohen lehtësisht këta fëmijë në klasë nga mësuesit dhe shokët ?
12. Si organizohet koha e lirë për këta fëmijë? A organizohen lodra , diskutime me tema edukative etj?
13. A pranohet nga ana e stafit ankesa, sugjerime nga këta fëmijë? Cilat kanë qenë sugjerimet e fundit nga fëmijët?
14. A ofron shtëpia kushtet e saj të përshtatshme për këta fëmijë ?
15. Çfarë ndodh me këta fëmijë pas moshës 14 vjeç? Çfarë lehtësimi social i ofrohet nga institucioni juaj? Sa mbështeten këta fëmijë nga institucionet lokale? Çfarë mund të bëhet me shumë në lidhje me përfshirjen sociale për këta fëmijë?